Për ushqimet dhe produktet ushqimore¹, do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për ushqimin.

Për artikujt ushqimor të mësipërm, ku kërkohet raport analizë, operatori ekonomik duhet të paraqes raport analizë origjinale ose kopje e noterizuar, lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi. Raport analiza përkatëse (fletë analizë për treguesit e sigurisë dhe cilësisë) duhet të jetë sipas llojit të produktit, numrit të lotit dhe jetëgjatësisë së produktit dhe të ketë lidhje me produktin. Në raport analizë duhet të jetë shënuar: emërtimi i produktit ose një e dhënë tjetër që tregon ose lidh këtë raport analizë me produktin.

Produkti kur të lëvrohet duhet të jetë i shoqëruar me certifikatën e origjinës sipas legjislacionit në fuqi për ushqimin.

Produktet ushqimore, objekt i vendimit të këshillit të ministrave nr. 1344 datë 10.10.2008 “Për miratimin e rregullave për etiketimin e produkteve ushqimore”, neni 4 dhe neni 13, të jenë të pajisura me etiketat respektive.

Për produktet ushqimore të freskëta të fruta-perimeve të pa përpunuara, do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit për ushqimin.

Në fletë analizat që do shoqërojnë çdo sasi të mallit të lëvruar, operatori ekonomik të shënojë sasinë e prodhimit që i referohet kjo fletë analizë.

Mbi ambalazhimin e artikujve ushqimor të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Autoriteti Kontraktor, në momentin e lëvrimit të mallit, do të verifikojë jetëgjatësinë e produktit me të cilin do të furnizohet, në përputhje me periudhën e parashikuar të konsumimit nga AK të produktit.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje parashikimet e nenit 92 pika 3 dhe nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”:

“[...]3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.[...]

[...]1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi. [...]

III.1.6. Gjithashtu, Komisioni sjell në vëmendje parashikimet e nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikat 2, 3 dhe 4:

“2.Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit;
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe
- iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3.Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

- a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.
- b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.
- c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.

4. Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”

III.1.7. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’ përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose

metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III.1.9. Nga shqyrtimi i specifikimeve teknike për mallrat objekt-prokurimi, Komisioni konstaton, se nga ana e autoritetit kontraktor janë parashikuar 48 artikuj, nga 44 të përcaktuar në Shtojcën 2 “Lista e cmimeve të artikujve” dhe shtojca 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të ekzekutimit”. Konkretisht konstatohet se në specifikimet teknike janë përfshirë edhe artikujt bizele bishtajore e freskët, cilësi e parë me numër rendor 3, hudhër e njomë cilësi e parë me numër rendor 15, mollë cilësi ekstra e freskët me numër rendor 32 dhe kumbëlla të thata me numër rendor 44, për të cilët janë dhënë në mënyrë të detajuar të gjitha kërkesat dhe treguesit që duhet të plotësojnë, për të përmbushur nevojat e autoritetit kontraktor.

III.1.10. Komisioni i Prokurimiti Publik gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vecantë të vendosur. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk i ka hartuar dokumentat e tenderit në përputhje me nenin 36 të ligjit për prokurimin publik, pasi në listën e cmimeve të artikujve dhe në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit mungojnë 4 artikuj. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është

ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentat e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se specifikimet teknike nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t'i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

III.1.11. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”*, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, ku parashikohet se: *“[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se mospërputhja e krijuar midis kërkesave të parashikuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike dhe shtojcës 2 “Lista e cimeve të artikujve” si dhe shtojcës 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, pjesë e dokumentave të tenderit, ndikon drejtpërdrejtë në hartimin e ofertës ekonomike të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe në vlerësimin e ofertave nga ana e KVO-së si dhe është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave*

Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-16658-12-29-2021, me objekt: *Loti 7 “Blerje Fruta- Perime”*, me fond limit 166,637,440 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 21.02.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Jonaid Myzyri në lidhje me vendimin e shumicës.

Si Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik shpreh mendimin kundër për sa i përket arsyetimit të vendimit mbi themelin e çështjes dhe rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-16658-12-29-2021, me objekt: *Loti 7 “Blerje Fruta- Perime*”, me fond limit 166,637,440 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 21.02.2022 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

I. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si në vijim: “Ofertuesi ndodhet në kushtet e nenit 81 “Ndërhyrja në ofertë”, pika 3 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Nga dokumentacioni i paraqitur në SPE (deklarata për kontratat e furnizimit, e kërkuar sipas pikës 6 seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit), rezulton se, për realizimin e objektit të këtij prokurimi, ofertuesi “Dajti Park 2007” ShPK do të furnizohet me të 44 artikujt e kërkuar, tek të njëjtët furnizues, siç ka deklaruar edhe ofertuesi “Sinani Trading” ShPK (pjesëmarrës në këtë lot)”, vërej se,

I.1. Lidhur me këtë pretendim të operatorit ekonomik ankimues shumica e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik është shprehur mbi anulimin e procedurës së prokurimit, për shkak të konstatimeve pjesë e arsyetimit të vendimit. Këto konstatime lidhen me faktin se autoriteti kontraktor në shtojcën për specifikimet teknike të procedurës së prokurimit ka parashikuar specifikime teknike për 48 artikuj ndërkohë në shtojcën 6 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të ekzekutimit” është parashikuar furnizimi me 44 artikuj.

Kufijtë dhe kompetencat e shqyrtimit të ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik janë të përcaktuara qartësisht në ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik”, si edhe në Rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik. Kështu, në pikën 1 të nenit 115 “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik”, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” janë përcaktuar detyrat e Komisionit të Prokurimit Publik, ku parashikohet se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e

paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë. Gjithashtu, në nenin 29 “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, përcaktohet se: **Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. Përbashkërisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos dhe për ligjshmërinë e tyre.”.**

I.2. E drejta e Komisionit të Prokurimit Publik për të anuluar pjesërisht ose plotësisht një veprim ose vendim të nxjerrë në kundërshtim me ligjin është gjithashtu një ndër të drejtat e dhëna nga neni 118 i Ligjit për Prokurimin Publik.

I.3. Në vlerësimin tim, si edhe në vendimmarrjen e qëndrueshme të Komisionit ndër vite e drejta për të anuluar një procedurë prokurimi nga ana e Komisionit është e lidhur ngushtësisht me objektin e ankesës dhe shkaqet e parashtruara në ankesë. Lidhja midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit është një parakusht *sine qua non*, që Komisioni të mund të vendosë për anulimin e procedurës së prokurimit.

I.4. Konkretisht, referuar informacionit të administruar, rezulton se pretendimi i parë i ankimuesit lidhet me kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ku kjo arsye skualifikimi është e mbështetur në parashikimet e nenit 81 “Ndërhyrja në ofertë”, pika 3 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën pikën 1 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT“ gërma “g” të Shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT “ të dokumenteve të tenderit, pra objekti i ankesës së ankimuesit është kundërshtimi i arsyes së kualifikimit të mësipërm të autoritetit kontraktor lidhur me ndërhyrjen në ofertë.

I.5. Në rastin konkret ky objekt i ankesës dhe kjo arsye skualifikimi nuk ka lidhje veprimet e tjera të autoritetit kontraktor dhe konkretisht me veprimet e njësisë së prokurimit dhe për më tepër me ligjshmërinë e veprimeve të këtij të fundit, pasi kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 1 “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT“ gërma “g” të Shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumenteve të tenderit është i hartuar në përputhje parashikimet e nenit 41 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe parashikimet e nenit 14 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

I.6. Së dyti, referuar edhe pretendimeve të ngritura për operatorin ekonomik të kualifikuar “Agro Koni” SHPK sërish konstatoj se nuk ekziston lidhja logjike dhe ligjore midis konstatimit se autoriteti kontraktor ka parashikuar specifikime teknike për 4 artikuj, artikuj të cilat nuk janë parashikuar për t’u furnizuar referuar shtojcës së ofertës ekonomike dhe të sasisë së mallrave të kërkuar. Akoma më tej, rezulton se referuar shtojcës 7 “ Formulari i

sasisë dhe grafiku i lëvrimit”, të dokumenteve të tenderit, është parashikuar që: Afatet e lëvrimit: Sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, por në çdo rast jo me herët se 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës”, ndërkohë referuar Formularit të Njoftimit të Kontratës, Marrëveshja Kuadër është parashikuar për 24 muaj. Pra, vlerësoj se përcaktimi i autoritetit kontraktor në lidhje me specifikimet teknike për të njëjtat artikuj është referuar edhe stinëve, pasi referuar formularit të sasisë dhe grafikut të lëvrimit, nuk ka një rregullim të posaçëm se për cilat produkte mund të mos kërkohen në stinë të ndryshme, pra furnizimi do të jetë në të gjithë stinët sipas kërkesave të autoritetit kontraktor ndaj edhe specifikimet teknike për të njëjtin produkt janë dhënë për stinë të ndryshme.

I.7. Referuar dokumentacionit të administruar nuk konstatoj se cili prej elementëve që ka sjellë anulimin e procedurës së prokurimit të ketë shkaktuar konfuzion, pengim të operatorëve ekonomikë apo pa mundësinë për të marrë pjesë në procedurën e zhvilluar, fakt të cilin e vërteton dhe pjesëmarrja e disa operatorëve ekonomikë në procedurë si edhe arsyet e skualifikimit si të operatorit ekonomik ankimues ashtu edhe për pretendimet që ngrihen për operatorin tjetër nga ankuesi.

I.8. Si rrjedhojë e arsyetimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 34, 46 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, gjykoj se është në tejkalim të objektit të ankesës. Një ndër qëllimet kryesore të ligjit për prokurimin publik është ai i efikasitetit dhe efikasitetit të procedurave të prokurimit, ndërkohë që anulimi i një procedure në tejkalim të objektit të ankimit dhe të lidhjes shkak-pasojë të konstatimit të lapsuseve në dokumentet e procedurës me arsyet e skualifikimit dhe me pretendimet që parashtrihen nga operatori i skualifikuar për operatorët e tjerë të kualifikuar nuk i shërben efikasitetit dhe efikasitetit të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

Gjithashtu, sqaroj se në nenin 98 pika 2 gërma c të ligjit për prokurimin publik, ligjvënësi ka sanksionuar se një procedurë prokurimi anulohet kur konstatohen se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme. Proporcionaliteti në anulimin e një procedure prokurimi lidhet vetëm me rastin kur në dokumentet e tenderit konstatohen gabime ose mangësi të rëndësishme, ndërkohë që në rastin konkret, në vlerësimin tim nuk ndodhemi para gabimeve të rëndësishme.

II. Së dyti, në lidhje me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007 ” ShPK vlerësoj se:

II.1. Në nenin 81 “Ndërhyrja në ofertë” e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet si vijon:

1. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.
2. Ndërhyrje në ofertë do të konsiderohet edhe pjesëmarrja e dy ose më shumë ofertuesve me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi.
3. Autoriteti/enti kontraktor vlerëson rast pas rasti nëse konstaton të dhëna të tilla, që mund të shërbejnë si tregues për ndërhyrje në oferta nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues.

I II.2. Nga verifikimi i ofertës së operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK rezulton, se është paraqitur “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, ku ndërmjet të tjerave, në Pjesën II, gërma “B” “Për dorëzimin e ofertave të pavarura” të këtij formulari, nga ana e ankimesit është pohuar se: 6. “Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër”. Në pikën 7, po këtu ankimesi ka deklaruar se nuk është konsultuar, nuk ka komunikuar, nuk ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi, dhe më pas në pikat 8, 9 dhe 10 ka pohuar se: “8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me: a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës”; “9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.” “10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart”.

II.3. Gjithashtu, rezulton, se është paraqitur “Deklaratë për kontratat e furnizimit”, nëpërmjet të cilës operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK deklaron se ka kontratë furnizimi për produktet fruta perime me shoqëritë “Kosmonte Foods” SHPK, “Masabi Frutis” SHPK dhe personi i tatueshëm fermer “A.Avrani” me të dhëna të hollësishme për çdo produkt sipas tabelës që e shoqëron këtë deklaratë, me emërtimet e artikujve, prodhuesin/distributorin, datën e nënshkrimit të fillimit të kontratës së furnizimit dhe datën e përfundimit të afatit të kontratës së furnizimit. Përveç këtyre deklaratave, janë paraqitur në SPE edhe tre kontrata dhe konkretisht:

1. Kontratë furnizimi datë 01.02.2022 lidhur ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” SHPK dhe shoqërisë “Kosmonte Foods Tirana” SHPK për artikullin “Bizele e ngrirë”.
2. Kontratë furnizimi datë 18.02.2022 lidhur ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” SHPK dhe shoqërisë “Masabi Frutis” SHPK për furnizimin me banane.
3. Kontratë furnizimi datë 19.02.2022 lidhur ndërmjet shoqërisë “Dajti Park 2007” SHPK dhe personit të tatueshëm “Andera Avrani” për furnizimin me perime, fruta, bostanore dhe prodhime të tjera bujqësore.

II.4. Në rastin konkret rezulton, se ankimuesi ka plotësuar kërkesën e parashikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit: *“në rast se operatori pjesëmarrës nuk është prodhues, por do të veproj me kontrata furnizimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen dhe operatorët me të cilët janë lidhur këto kontrata duhet ta ushtrojnë aktivitetin e tyre konform, legjislacionit në fuqi”*, duke paraqitur deklaratën sipas së cilës rezulton se shoqëria “Dajti Park 2007” SHPK ka kontratë furnizimi për produktet fruta perime me shoqëritë “Kosmonte Foods” SHPK, “Masabi Frutis” SHPK dhe person i tatueshëm fermer “A.Avrami”, me të dhëna të hollësishme për çdo produkt, sipas tabelës që e shoqëron këtë deklaratë, me emërtimet e artikujve, prodhuesin/distributorin, datën e nënshkrimit të fillimit të kontratës së furnizimit dhe datën e përfundimit të afatit të kontratës së furnizimit si dhe duke paraqitur kontratat e furnizimit me këta furnitorë. Lidhur me argumentin e autoritetit kontraktor se, *“[...] për realizimin e objektit të këtij prokurimi, ofertuesi “Dajti Park 2007” ShPK do të furnizohet me të 44 artikujt e kërkuar, tek të njëjtët furnizues, siç ka deklaruar edhe ofertuesi “Sinani Trading” ShPK (pjesëmarrës në këtë lot)”, duke përbërë ndërhyrje në ofertë”*, rezulton se ankimuesi ka paraqitur formularin e vetëdeklarimit, ku deklaroi se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër si dhe nuk ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi, *deklaratë e cila përforcohet edhe në pikat 8, 9 dhe 10 të formularit të vetëdeklarimit si më sipër cituar.*

II.5. Sa më sipër cituar, gjykoj se operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 81 “Ndërhyrja në ofertë” e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, pika 1 dhe 2, pasi kjo shoqëri nuk ka marrë pjesë në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, si dhe nuk është në kushtet e pjesëmarrjes së tij me ofertues të tjerë me të njëjtin ortak dhe/ose administrator në të njëjtën procedurë prokurimi. Për sa i përket rastit të tretë të këtij vendimi, të cilit i referohet edhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave se: *“Autoriteti/enti kontraktor vlerëson rast pas rasti nëse konstaton të dhëna të tilla, që mund të shërbejnë si tregues për ndërhyrje në oferta nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues”*, autoriteti kontraktor rezulton, që nuk ka dhënë argumente dhe prova bindëse mbi këtë skualifikim, por ka ngritur dyshime pa një hetim të thelluar.

Vlerësoj se rastet e ndërhyrjes në ofertë janë të mirëpëcaktuara në rregullat e prokurimit publik, por ndërkohë në rastin konkret vlerësoj se nga Komisioni mund të ishte kërkuar *amicus curia* në përputhje me nenin 31 pika 3 të VKPP 766/2021 pranë Autoritetit të Konkurrencës në rast se sjellja e mësipërme e operatorëve mund të përbënte marrëveshje të ndaluar në kuptim të ligjit nr.9121 datë 28.7.2003 *“Për Mbrojtjen nga Konkurrenca”*, i ndryshuar.

III. Ndërkohë në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK për operatorin ekonomik të kualifikuar “Agro Koni” SHPK, vlerësoj se:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” ShPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro – Koni” SHPK, me arsyetimin se “Nuk plotëson pikën 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë. Shoqëria “Agro – Koni” SHPK sipas ekstraktit historik në QKB ushtron aktivitetin e saj si më poshtë:

1. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri Durrës Maminas MAMINAS, Lagja Maminas, rruga Gjiri i Lalzit, ndërtesa nr.010.

-Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit:

2. Fier Lushnje LUSHNJE Tregu i Shumicës Fruta Perime

3. Durrës Shijak SHIJAK Koxhas, objekti Sere nr pasurie 223/32 në zonën kadastrale nr.1186 me sipërfaqe 6800 m2, nr pasurie 6/23 me sipërfaqe 1663 m2, nr pasurie 6/5 me sipërfaqe 8276 m2, nr pasurie 6/22 me sipërfaqe 1663 m2.

Gjithashtu referuar faqes online të QKB subjekti Agro Koni është i pajisur me Licencat:

1. LN-3405-12-2021 Kodi II.1.A.1 Ambalazhim paketim dhe shpërndarje me shumicë e fruta perimeve në adresën: Durrës Maminas , MAMINAS Lagja Maminas, rruga Gjiri i Lalzit, ndërtesa nr.010”,
2. LN-3906-10-2011 Kodi II.1.C Prodhim Fruta Perime me Adresë: Qarku Durrës, B/K Maminas, QF Maminas, Maminas
3. LN-3907-10-2011 Kodi II.4 Tregtim me Shumicë I Farave dhe fidanëve me Adresë Qarku: B/K Maminas, QF Maminas, Maminas
4. PN-8735-12-2014 Kodi III.1.A Leje Mjedisore e tipit C për aktivitetin: Magazinim frigoriferik I produkteve ushqimore të ambalazuara mbi 20 Ton, me adresë Qarku Durrës, B/K Maminas, QF Maminas, Maminas
5. L/N-0200-10-2015 Kodi II.3.C Tregtim me shumicë I kafshëve të gjalla (Bletë për Pjalmim) me adresë Qarku Fier, B/K: Lushnje, QF: Lushnje, Lushnje.

Referuar sa më sipër në selinë qendrore subjekti Agro – Koni është i paisur me licencën LN-3405-12-2021 Kodi II.1.A.1 Ambalazhim paketim dhe shpërndarje me shumicë e fruta perimeve.

Në vendushtrimin e aktivitetit me adresë Fier Lushnje LUSHNJE Tregu I Shumicës Fruta Perime rezulton se është i pajisur L/N-0200-10-2015 Kodi II.3.C Tregtim me shumicë I kafshëve të gjalla (Bletë për Pjalmim).

Ndërsa në adresën: Durrës, Shijak SHIJAK Koxhas, objekti Sere nr pasurie 223/32 në zonën kadastrale nr.1186 me sipërfaqe 6800 m2, nr pasurie 6/23 me sipërfaqe 1663 m2, nr pasurie 6/5 me sipërfaqe 8276 m2, nr pasurie 6/22 me sipërfaqe 1663 m2, e cila sipas Ekstraktit Historik në QKB është hapur si vend ushtrimi aktiviteti më datë 30.09.2020 rezulton të mos jetë i pajisur Licencën përkatëse.

Gjithë sa më sipër ky operator nuk plotëson pikën 2.1 nënpika 1 mbi Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë për dy arsye thelbësore:

1. Stabilimentet e deklaruara sipas QKB-së nuk janë të pajisura me Licencat përkatëse.
2. Subjekti i cili deklarohet si prodhues i produkteve objekt prokurimi nuk rezulton me asnjë Licencë të rregullt për prodhimin e Fruta Perimeve. Dy Licencat e vetme të cilat kanë përputhje me vendin e ushtrimit të aktivitetit janë për Ambalazhim paketim dhe shpërndarje me shumicë e fruta perimeve si dhe Tregtim me shumicë i kafshëve të gjalla (Bletë për pjalmim). Shihet fare qartë që subjekti Agro – Koni është në kushtet e ushtrimit të aktivitetit

në kundërshtim me rregullat në fuqi si dhe të deklaramit të pavërtetë lidhur me statusin e tij si subjekt prodhues.”, vërej se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”**, në emër të tij, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet te jete i licencuar sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nenligjore).*

Shënim 1.1:

Operatori ekonomik ne zbatim te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Për ushqimin”, konkretisht neni 19, për çdo stabiliment qe disponon (pronësi dhe/ose qira) te paraqes tabelën me informacion si me poshtë:

Nr.	Vendndodhja	Statusi	Nr. i regjistrimit të posaçëm
1		Pronësi/qira/përdorim	
Etj.		Pronësi/qira/përdorim	

Detyrimisht duhet qe çdo stabiliment duhet te jete i pajisur me licence përkatëse. Ne rast te konstatimit te ushtrimit te stabilimentit jo ne perputhje me kete nen do te referohen prane AKU per ndjekjen e procedurave perkatese administrative sipas nenin 68 te ligjit nr. 9863, date 28.01.2008 “Per ushqimin”.

Stabilimenti/stabilimentet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Agro - Koni” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar
- Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar
- Deklaratë për ambientet në disponim pika 2.1, nën-pika 1 me përmbajtje si vijon:
“Në përgjigje të kësaj kërkesë, deklarojmë se Operatori Ekonomik “Agro – Koni” SHPK, me Nipt J81409007P ka në pronësi Stabilimentin i cili në zbatim të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, është i pajisur me Licencë të kategorisë “II.1.A.1 – Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, me numër LN-3405-12-2021, në emër të OE Agro – Koni ShPK, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, dhe si në tabelën e mëposhtme paraqesim të dhënat për stabilimentin që ne, OE Agro – Koni ShPK disponojmë:

Nr.	Vendndodhja	Statusi	Nr. i regjistrit të posaçëm
1.	Maminas, Rruga Gjiri i Lalzit, Ndërtesa nr. 010, Durrës	Në pronësi	LN-3405-12-2021

- Licencë LN-3405-12-2021, Kodi II.1.A, në emër të subjektit Agro – Koni; Kategoria – Prodhim dhe/ose tregtim i ushqimeve; Nënkatëgoria – Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve; Veprimtari specifike – Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz; Emërtimi përshkruar i veprimtarisë – Ambalazhim paketim e shpërndarje me shumicë e fruta – perimeve; Vendi i kryerjes së veprimtarisë: Qarku Durrës, Rrethi Durrës, B/K: Maminas Q/F: Adresa Durrës DURRËS Maminas, MAMINAS Durrës DURRES, MAMINAS Lagja Maminas, rruga Gjiri i Lalzit, ndërtesa nr.010”

III.1.3. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.5. Në nenin 41 pika 4 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.1.6. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: “Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregtimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.

III.1.7. Referuar sa më lart, vërej, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka kërkuar që për çdo stabiliment që disponon (pronësi dhe/ose qira) ofertuesit duhet të paraqesin informacionin në një tabelë lidhur me vendndodhjen, statusin në pronësi/qira/përdorim, si dhe numrin e regjistrimit të posaçëm, si dhe ka kërkuar që çdo stabiliment duhet të jete i pajisur me licence përkatëse. Akoma më tej, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, se në rast të konstatimit të ushtrimit të stabilimentit jo në përputhje me ligjin do të referohen pranë AKU për ndjekjen e procedurave përkatëse administrative sipas nenit 68 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Agro – Koni” ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, konstatoj, se është dorëzuar në përputhje me kërkesat në kriter deklarata mbi ambientet në disponim. Konkretisht ankimuesi ka deklaruar vendndodhjen, statusin dhe numrin e regjistrimit të posaçëm për një ambient/stabiliment.

Ankimuesi ka paraqitur licencën përkatëse për vendin e deklaruar të ushtrimit të aktivitetit me veprimtari specifike “**Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë për njerëz**”, si dhe emërtimi përshkrues i veprimtarisë “**Ambalazhim paketim e shpërndarje me shumicë e fruta – perimeve**.”

Sa i takon pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se “Stabilimentet e deklaruar sipas QKB-së nuk janë të pajisura me Licencat përkatëse, si dhe Subjekti i cili deklarohet si prodhues i produkteve objekt prokurimi nuk rezulton me asnjë Licencë të rregullt për prodhimin e Fruta Perimeve”, gjykoj, se autoriteti kontraktor, në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e ofertuesve të deklarojnë stabilimentet që disponojnë dhe këto stabilimente të jenë të pajisura me licencat përkatëse, kërkesa këto të cilat referuar arsytimit sa më sipër janë përmbushur nga ana e ankimuesit.

Fakti që subjekti ka deklaruar në ekstraktin e regjistrit tregtar disa vende të ushtrimit të aktivitetit, jo domosdoshmërisht të gjitha këto vende kanë cilësinë e stabilimenteve në të cilat kryhet veprimtaria e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes me shumicë e ushqimeve për njerëz. Kështu që, rrjedhimisht operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK me dokumentacionin e paraqitur vërteton se stabilimenti i deklaruar për ushtrimin e aktivitetit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, është i pajisur me licencën përkatëse të kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriteret e kualifikimit.

Sa më sipër vlerësoj se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro – Koni” ShPK, me argumentin se “*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim xhiro vjetore për vitet financiare (2018, 2019, 2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40 % e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*”, vërej se,

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2018, 2019, 2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit Nr. T05550384 datë 16.02.2022 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, në emër të operatorit ekonomik Agro Koni me përmbajtje “...në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitura për vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:

Nr.	Periudha Tatimore	Shuma
1	20-A	193,011,558
2	19-A	197,569,239
3	18-A	157,362,028

Ky vërtetim lëshohet për pjesëmarrjen në tenderin që zhvillohet në datën 2022-02-21, sipas ftesës së bërë nga enti prokurues (institucioni): Agjencia e Blerjeve të

Përqendruara, me objekt-prokurimi: Loti 7 “Blerje fruta – perime”, me vlerë: 166637440 Lekë, me vendndodhje në Tiranë.

III.2.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

III.2.4. Neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
- b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.2.5. Referuar dokumenteve të tenderit, për Lotin 7, Shtojca 7, pika 2.2.2 konstatohet se, autoriteti kontraktor ka parashikuar që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2018, 2019, 2020), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK konstatohet se ky i fundit ka paraqitur Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit Nr. T05550384 datë 16.02.2022 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, në të cilin pasqyrohet xhiro e tre viteve të fundit, 2018, 2019, 2020 të subjektit ”Agro – Koni” SHPK. Nga verifikimi i këtij dokumenti konstatohet se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar është më e lartë se 40% e vlerës së fondit limit të lotit, kërkesë kjo e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Pra, me anë të këtij dokumenti, vërtetohet në mënyrë të qartë dhe eksplicite xhiroja e aktivitetit tregtar të tre viteve të fundit të operatorit ekonomik “Agro - Koni” SHPK. Pra qëllimi për të cilin autoriteti kontraktor vendos në kriteret e veçanta një kërkesë të tillë, është të vërtetojë se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të operatorit ekonomik i cili pretendon të fitojë kontratën, të jetë më e lartë se 40% e vlerës së fondit limit të lotit, kështu që rrjedhimisht, operatori ekonomik “Agro Koni” SHPK me dokumentin e paraqitur vërteton përmbushjen e këtij kriteri.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Agro – Koni” SHPK me arsyetimin se *“Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjor ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”,* vërej se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresë nr. 6695 prot., datë 09.12.2021 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me përmbajtje: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 07.12.2021, ju konfirmojmë kopje të pasqyrave financiare për periudhën:*
- *2020 të dorëzuar elektronikisht datë 30.03.2021 pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë*
- *2019 të dorëzuar elektronikisht datë 21.07.2020 pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë*
- *2018 të dorëzuar elektronikisht datë 25.03.2019 pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë”*
- Pasqyrat financiare viti 2018, të vulosura nga organet tatimore, shoqëruar me Raport të audituesit të pavarur, datë 11.03.2019
- Pasqyrat financiare viti 2019, të vulosura nga organet tatimore, shoqëruar me Raport të audituesit të pavarur, datë 28.03.2020
- Pasqyrat financiare viti 2020, të vulosura nga organet tatimore, shoqëruar me Raport të audituesit të pavarur, datë 28.03.2021

III.3.3. Në nenin 77, pika 1, 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.3.4. Në nenin 41, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.*

III.3.5. Në ligjin 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, neni 41, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar; b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit; c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”*

III.3.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Gjyko se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Sa më sipër, konstatoj, se në kriterin e veçantë të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare 2018, 2019, 2020 të paraqitur në autoritetet përkatëse tatimore, si dhe në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Agro -Koni” SHPK, vërej, se janë dorëzuar pasqyrat financiare për vitet 2018, 2019, 2020 të subjektit, të firmosura dhe vulosura nga organet tatimore, si dhe shoqëruar nga raporti i audituesit të pavarur. Në këto kushte, gjykoj, se operatori ekonomik “Agro - Koni” SHPK, përmbush kriterin e kualifikimit në shtojcën 7, të dokumenteve të tenderit, të ngarkuar në SPE, konkretisht pika 2.2.2. të “Kapacitetit ekonomik dhe financiar” të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro – Koni” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin “[...]Nuk plotëson pikën 2.3 Kapaciteti teknik: 1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë: a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. [...]”, vërej se:

III.4.1. Në shtojcën 7, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik” në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*
 - a) *Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.4.2. Në shtojcën 6, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, për Loti 7 “Blerje fruta dhe perime”, në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Sasia e mallit që kërkohet:

FRUTA DHE PERIME -TABELA E PËRGJITHSHME			
Nr.	Emërtimi i artikujve ushqimorë	Njësia matëse	Sasi të e pritshme
1	Bizele e njomë kokërr, cilësi e parë	Kg	6766
2	Bizele e ngrirë kokërr, cilësi e parë	Kg	2762
3	Barbunja, cilësi e parë	Kg	13238
4	Panxhar i kuq, cilësi e parë	Kg	170
5	Bamje, cilësi e parë	Kg	3991
6	Sallatë jeshile, cilësi e parë	Kg	490
7	Presh, cilësi e parë	Kg	68734
8	Spinaq, cilësi e parë	Kg	35662.5
9	Domate, cilësi e parë	Kg	85737.5
10	Trangull, cilësi e parë	Kg	640
11	Qepë e thatë, cilësi e parë	Kg	208551
12	Qepë e njomë, cilësi e parë	Kg	9538
13	Hudhër e thatë, cilësi e parë	Kg	440
14	Patate, cilësi e parë	Kg	595272
15	Lakër e bardhë, cilësi e parë	Kg	81042.5
16	Lakër e kuqe, cilësi e parë	Kg	120
17	Specë, cilësi e parë	Kg	42560
18	Patëllxhan, cilësi e parë	Kg	34479.5
19	Lulelakër, cilësi e parë	Kg	568
20	Brokoli, cilësi e parë	Kg	523
21	Rukola, cilësi e parë	Kg	220
22	Kungull, cilësi e parë	Kg	48066
23	Karrota, cilësi e parë	Kg	85564
24	Selino, cilësi e parë	Kg	30
25	Majdanoz, cilësi e parë	Kg	59
26	Kopër, cilësi e parë	Kg	38
27	Pjepër, cilësi e parë	Kg	558
28	Kaki (Hurma), cilësi e parë	Kg	689
29	Qershi, cilësi e parë	Kg	516
30	Mollë, cilësi e parë	Kg	293510
31	Portokalle, cilësi e parë	Kg	79849
32	Banane, cilësi e parë	Kg	1314

33	<i>Mandarinë, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>17268</i>
34	<i>Dardhë, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>6768</i>
35	<i>Pjeshkë, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>16803</i>
36	<i>Nektarinë, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>16738</i>
37	<i>Shalqi, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>516</i>
38	<i>Rrush, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>436</i>
39	<i>Luleshtrydhe, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>386</i>
40	<i>Kumbulla, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>4524</i>
41	<i>Fiq, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>386</i>
42	<i>Limon, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>140</i>
43	<i>Kivi, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>506</i>
44	<i>Kajsi, cilësi e parë</i>	<i>Kg</i>	<i>6538</i>

III.4.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

1. Fatura tatimore me shitës “Agro Koni” SHPK dhe blerës “Zico” SHA për vitin 2021.

Konkretisht si më poshtë:

- Korrik 2021 – Faturat nr.53; 87; 100; 113; 114; 136; 148; 162; 179; 216; 217; 224; 233; 235; 240; 243; 244; 245; 246;
- Gusht 2021 – Faturat nr 247; 249; 256; 262; 275; 276; 278; 303; 304; 305; 310; 311; 312; 313; 314; 315; 330; 332; 335; 336; 337
- Shtator 2021 – Faturat nr. 342; 343; 344; 347; 351; 353; 355; 356; 359; 360; 361; 364; 365; 366; 369; 370; 374; 375; 376; 377; 378; 379; 380; 382; 383; 386; 388;
- Tetor 2021- Faturat nr. 390; 391; 392; 393; 410; 413; 414; 416; 417; 418; 420; 423; 424; 428; 435; 436; 440; 441; 444; 445; 446;
- Nëntor 2021- Faturat nr. 458; 460; 461; 462; 463; 465; 469; 472; 473; 474; 475; 478; 481; 483; 484; 488; 489; 490; 492; 497; 499; 500; 502; 504; 505; 512; 515; 519; 520; 521; 523; 524; 527

2. Fatura eksporti me shitës “Agro – Koni” SHPK dhe blerës “Uab Jotagris” me adresë Vilnius, për vitin 2021 me nr. 8; 9; 69; 71; 72; 79; 80; 81; 82; 83; 84; 85; 92; 85; 99; 102; 104; 106; 108; 110; 112; 116; 119; 121; 123; 125; 127; 129; 131; 133; 135; 139; 141; 143; 145; 147; 150; 155; 157; 159; 161; 174; 176; 178; 181; 183; 185; 187; 189; 191; 193; 195; 197; 199; 203; 205; 207; 209; 211; 213; 215; 219; 221; 223; 226; 228; 230; 232; 237; 239; 242

3. Fatura tatimore me shitës “Agro Koni” SHPK dhe blerës “MC Catering” SHPK për vitin 2019. Konkretisht si më poshtë:

- Mars 2019 – Faturat nr. 130; 133; 134; 135; 136; 139; 141; 142; 144; 147; 148; 150; 151; 155; 156; 159; 163; 164; 166; 167; 168; 172; 177; 176; 180; 179; 183; 185; 184; 186
- Maj 2019 – Faturat nr.244; 245; 247; 248; 249; 250; 251; 253; 255; 256; 257; 258; 260; 261; 262; 263; 266; 268; 269; 270; 271; 272; 273; 275; 276; 277; 278; 280; 281; 282; 283;
- Prill 2019 – Faturat nr. 190; 191; 193; 192; 196; 199; 198; 200; 203; 202; 204; 205; 207; 209; 208; 212; 215; 214; 217; 216; 219; 221; 220; 224; 223; 228; 227; 226; 231; 233; 232; 234; 239;

- Qershor 2019 - Faturat nr. 286; 289; 290; 293; 292; 295; 297; 298; 299; 300; 301; 304; 306; 307; 309; 316; 317; 318; 319; 322; 324; 325; 327; 328; 329; 333; 334; 336; 338; 342;
- Korrik 2019 – Faturat nr. 352; 353; 354; 357; 359; 269; 273; 378; 381; 384; 388; 390; 392; 394; 396; 398; 401; 402; 404; 407; 411; 413; 414;
- Gusht 2019 - Faturat nr. 416; 417; 421; 422; 424; 428; 431; 435; 434; 437; 439; 449; 446; 447; 450; 453; 461; 462; 463; 465; 466;
- Shtator 2019 - Faturat nr. 471; 473; 475; 477; 481; 483; 485; 487; 489; 491; 492; 494; 495; 497; 503; 504; 505; 508; 509; 511; 512; 513; 515; 520; 521; 522;
- Tetor 2019 – Faturat nr. 523; 525; 527; 528; 529; 531; 532; 533; 535; 536; 538; 540; 541; 543; 548; 549; 552; 553; 556; 557; 559; 560; 561; 566; 567; 569; 570; 572; 575; 576; 578; 582; 584; 585; 589; 590; 592; 593;
- Nëntor 2019 – Faturat nr. 652; 651; 645; 643; 642; 638; 639; 635; 636; 632; 633; 628; 626; 627; 623; 621; 620; 618; 619; 615; 611; 612; 607; 604; 605; 601; 602; 597
- Dhjetor 2019 – Faturat nr. 661; 662; 663; 664; 666; 672; 673; 674; 678; 680; 681; 683; 690; 691; 694; 695; 698; 699; 701; 702; 704; 711; 710; 709; 713; 717; 716; 719; 722; 724;
- Fatura tatimore shitje nr. 472 datë 27.11.2019 me shitës “Agro Koni” SHPK dhe blerës “Gustoza” SHPK.

III.4.4. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konstatoj se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin “dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”

III.4.5. Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Agro - Koni” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, vërej, se ky i fundit ka paraqitur Fatura Tatimore Shitje për furnizimin e disa subjekteve private me produkte si fruta dhe perime (Domate, Kastravec, Mollë, Karota, Pjepër, Selino, Majdanoz, Qepë, Spinaq, Patate, Limon, Pjeshka, Hudhër, Presh, Borzilok, Dardhë, Portokall, Kungull, Brokoli, Lule Lakër, Kungull i verdhë, Mandarina, Kivi, Banane, Kajsi, Kumbulla, Mashurka, Ullinj, Shalqi).

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Agro - Koni” SHPK në lidhje me eksperiencën e ngjashme, KPP, konstaton se, me dokumentacionin e paraqitur, ky i fundit vërteton se ka kryer furnizime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti, duke plotësuar kështu kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit për sa i përket eksperiencës së ngjashme.

Konkretisht, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK, konstatoj se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjithë elementëve të faturave të paraqitura, vërtetohet se furnizimet e kryera janë të ngjashme me furnizimet që kërkohen nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi, si dhe plotësojnë vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro – Koni” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me argumentin “[...]Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktore [...]”, vërej se:

III.5.1. Në shtojcën 7, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik” në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore**.

III.5.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë e operatorit ekonomik “Agro – Koni” SHPK, me nr.11/07 prot., datë 21.02.2022, me përmbajtje si vijon:

“Në, Kompania “Agro – Koni” SHPK me nipt J81409001P, në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë 21.02.2022, nga Autoriteti Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me objekt kontratë/marrëveshje kuadër “Blerje Artikuj Ushqimorë” ndarë në 7 (shtatë) lote/ Loti 7 “Blerje Fruta – perime” me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj; - REF-16658-12-29-2021, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,637,440 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet) lekë (pa TVSh). Referuar kërkesës në Shtojcën 1 dt 17.01.2022, Seksioni 2

1.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

2.Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.3 Kapaciteti teknik:

II 2.Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Deklarojmë se Operatori Ekonomik “Agro – Koni” SHPK me Nipt J81409001P marrim përsipër të kryejmë shërbimin e transportit në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.”

III.5.3. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konstatoj se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin një deklaratë, me anë të së cilës marrin përsipër të kryejnë shërbimin e transportit në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për mospërbushje të këtij kriteri nga operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK, nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga ky i fundit për përmbushjen e kriterit të mësipërm, konstatoj se operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK ka paraqitur dokumentin ‘Deklaratë’, ku ky i fundit deklaron se merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore, për këtë procedurë prokurimi.

Pra sa më sipër, duke qenë se autoriteti kontraktor, në kriteret e kualifikimit ka kërkuar shprehimisht përmbushjen e këtij kriteri me anë të një deklaratë nga operatori ekonomik i cili pretendon të fitojë kontratën, konstatoj se operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK, me dokumentacionin e paraqitur e ka përmbushur këtë kriter.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK nuk qëndron.

III.6. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “[...]3. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 6 (gjashtë) automjete ATP (jo frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.*

Per sa me sipër operatori ekonomik te paraqese nje deklaratë perkatëse sipas formatit te mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				<i>Pronesi/qira/perdorim</i>
2				<i>Pronesi/qira/perdorim</i>
3				<i>Pronesi/qira/perdorim</i>
4				<i>Pronesi/qira/perdorim</i>
5				<i>Pronesi/qira/perdorim</i>
6				<i>Pronesi/qira/perdorim</i>

Shenim:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatëse mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, certifikatën për transportin e lendeve të rrezikshme dhe pasaportën e mjetit për kapacitetin mbajtes ne litra.

Per mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

Referuar Ekstraktit Historik të QKB-së subjekti Agro – Koni nuk ka të pasqyruar asnjë automjet për ushtrimin e aktivitetit”, vërej se:

III.6.1. Në Shtojcën Nr.1, datë 09.02.2022 për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin si më poshtë:

Shtojca 7.

Loti 7 “Blerje Fruta- Perime”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

ISHTE Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 6 (gjashtë) automjete ATP (jo frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi ose me qira. Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim
3				Pronesi/qira/perdorim
4				Pronesi/qira/perdorim
5				Pronesi/qira/perdorim
6				Pronesi/qira/perdorim

Shenim:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesë librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, certifikatën për transportin e lendeve të rrezikshme dhe pasaportën e mjetit për kapacitetin mbajtes në litra.

Per mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

BËHET:

3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 6 (gjashtë) automjete ATP (jo frigorifer), për transportin e mallrave, të cilin duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim
3				Pronesi/qira/perdorim
4				Pronesi/qira/perdorim
5				Pronesi/qira/perdorim
6				Pronesi/qira/perdorim

Shenim:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesë librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Per mjetet qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

III.6.2. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, nga verifikimi i dokumenteve të tenderit, rezulton se në shtojcën 7, pika 2.3.3 (modifikuar me Shtojcën 1 datë 09.02.2022) janë parashikuar kërkesat në lidhje me disponimin e automjeteve, **por nuk evidentohet të jetë përcaktuar ndonjë kërkesë që këto automjete të jenë të pasqyruara në Ekstraktin Historik të QKB të operatorit ekonomik, madje në asnjë vend në dokumentet e tenderit nuk është përcaktuar ndonjë kërkesë e tillë për mjetet.**

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë për pasqyrimin e automjeteve në Ekstraktin Historik të shoqërisë, ndaj mos pasqyrimi nuk mund të përbëjë shkak për kualifikimin/skualifikimin e një operatori ekonomik. Për pasojë, gjykoj se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin në shqyrtim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk është ndonjë kërkesë e tillë, rrjedhimisht, vlerësimi i kësaj oferte nuk mund të bëhet mbi kritere të cilat nuk janë kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro – Koni” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me argumentin “[...]Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore. [...]”, vërej se:

III.7.1. Në shtojcën 7, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

5.Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka

detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

III.7.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë e operatorit ekonomik “Agro – Koni” SHPK, me nr.11/04 prot., datë 21.02.2022, me përmbajtje si vijon:

“Ne, Kompania “Agro – Koni” SHPK me nipt J81409001P, në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë 21.02.2022, nga Autoriteti Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me objekt kontratë/marrëveshje kuadër “Blerje Artikuj Ushqimorë” ndarë në 7 (shtatë) lote/ Loti 7 “Blerje Fruta – perime” me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj; - REF-16658-12-29-2021, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,637,440 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet) lekë (pa TVSh). Referuar kërkesës në Shtojcën 1 dt. 17.01.2022, Seksioni 2

1.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

5.Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqese një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetedeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Operatori Ekonomik “Agro – Koni” SHPK me Nipt J81409001P sipas pikës 5 të shtojcës 7, të lotit 7, deklarojmë se operojmë duke plotësuar standardet respektive në fuqi të sigurisë ushqimore, për këtë kemi paraqitur Procesverbalin e Kontrollit të fundit të ushtruar nga autoriteti i A.K.U-së me nr. Autorizimi Nr: AKU-DR-2021-003707-1, NR procesverbali Nr; AKU DR-2021-003707-2, Listë verifikimi Nr:AKU DR-2021-003707-2/1, dhe vendim përfundimtar AKU DR-2021-003707-5, ku rezulton se OE Agro Koni ShPK ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.”

- Autorizim Inspektimi Nr. AKU-DR-2021-003707-1, datë 17.12.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
- Procesverbal Inspektimi Nr. AKU-DR-2021-003707-2, datë 17.12.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
- Listë Verifikimi Nr. AKU-DR-2021-003707-2/1, datë 17.12.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
- Vendimi Përfundimtar i Inspektimit Nr. AKU-DR-2021-003707-5, datë 17.12.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

III

III.7.3. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konstatoj, se autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetedeklarojnë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues,

përpara lidhjes së marrëveshjes kuadër ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për mospërmbushje të këtij kriteri nga operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK, nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga ky i fundit për përmbushjen e kriterit të mësipërm, konstatoj se operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK ka paraqitur vetëdeklarimin ku citon se ushtron aktivitetin konform kërkesave ligjore, duke paraqitur dokumentacionin e kontrollit të fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Pra sa më sipër, duke qenë se autoriteti kontraktor, në kriteret e kualifikimit ka kërkuar shprehimisht përmbushjen e këtij kriteri me anë të një deklaratë nga operatori ekonomik i cili pretendon të fitojë kontratën, konstatohet se operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK, me dokumentacionin e paraqitur e ka përmbushur këtë kriter.

Akoma më tej, edhe pse në kriterin e kualifikimit dokumentacioni provues i deklaramentit kërkohet nga autoriteti kontraktor të paraqitet nga operatori ekonomik nëse do të shpallet fitues, operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK, bashkëlidhur deklaramentit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin provues si Autorizim Inspektimi, Procesverbal Inspektimi, Listë Verifikimi, si dhe Vendimin Përfundimtar të Inspektimit datë 17.12.2021, lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ku vërtetohet se nga kontrolli i ushtruar, subjekti “Agro – Koni” SHPK, ushtron aktivitetin e tij konform kërkesave ligjore.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Agro Koni” SHPK, se ky i fundit nuk plotëson kriterin *“Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si me poshte:*

Stafi	Nr.
<i>Shofer</i>	<i>6</i>
<i>Punetore te thjeshte</i>	<i>6</i>
Total	12

- Per punonjesit e punesuar shofer të paraqitet kontrate pune perkatese si dhe leje drejtimi per secilin.

- Per punonjesit e punesuar punetore te thjeshte të paraqitet vetem kontrate pune perkatese.

- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

<i>Nr</i>	<i>Emer Mbiemer</i>	<i>Profesioni</i>	<i>Data e fillimit te marredhenieve te punësuar</i>

“, vërej se,

III.8.1. Në shtojcën 7, të dokumenteve të tenderit, në pikën pikat 2.3.4 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë:

4. Operatori/et ekonomik pjesemarrës për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	6
Punetore të thjeshtë	6
Total	12

- Për punonjësit e punësuar shofer të paraqitet kontrate pune perkatese si dhe leje drejtimi për secilin.
- Për punonjësit e punësuar punetore të thjeshtë të paraqitet vetëm kontrate pune perkatese.
- Operatori ekonomik të paraqes deklarate në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

IV

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës

Shënim:

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE paraqet në staf të 1 punonjësi, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit të tipit B dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të artikujve ushqimorë, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

V Për punonjësit që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

VI

III.8.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Agro Koni” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formularin përmbledhës së Vetëdeklarimit për “Agro Koni” SHPK;
- Deklaratë lidhje me stafin që disponon, ku deklarohen punonjësit, profesioni dhe data e fillimit të marrëdhënieve të punës.

III.8.3. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Në nenin 40, pika 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

5.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.8.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Vlerësoj se, kriteri i kualifikimit mbi disponimin e punonjësve duhet të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga operatori ekonomik sipas shtojcës 8 të dokumenteve të tenderit në respektim të nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të VKM, duke përmbushur kriterin kualifikues mbi disponimin e punonjësve për këtë fazë, ku autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në rastin konkret, në plotësimin e këtyre kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE): Formularin përmbledhës së Vetëdeklarimit për “Agro Koni” SHPK; Deklaratë lidhje me

stafin që disponon, ku deklarohen punonjësit, profesioni dhe data e fillimit të marrëdhënieve të punës, duke përmbushur kështu, në këtë moment kriterin kualifikues mbi disponimin e punonjësve për këtë fazë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK nuk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Agro Koni” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se “*Subjekti Agro – Koni është deklaruar si subjekt prodhues i fruta perimeve. Ndër të tjera ky subjekt deklaron se është prodhues edhe i frutit të bananes dhe bizeles së ngrirë. Sikurse e përmendëm edhe më sipër ky subjekt është në kushtet e deklaramit të pavërtetë pasi pikë së pari nuk disponon Licencat përkatëse për prodhimin e produkteve bujqësore të cilat mund të kultivohen në vendin tonë dhe akoma më tej të produkteve të importit të tilla si Banania (e cila kërkon klimë tropikale) dhe bizele të ngrirë (e cila kërkon procese teknologjike përpunimi dhe ambalazhimi)*”, vërej se,

III.9.1. Në Shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin si më poshtë:

ISHTE

6. Në rast se operatori pjesëmarrës nuk është prodhues, por do të veproj me kontrata furnizimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen dhe operatorët me të cilat janë lidhur këto kontrata duhet ta ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit në fuqi.

BËHET

6. Në rast se operatori pjesëmarrës nuk është prodhues, por do të përmbush kërkesat e AK me kontrata furnizimi për të gjithë artikujt objekt prokurimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen sipas tabelës nr 1. Operatorët palë të këtyre kontratave furnizimi duhet ta ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit në fuqi .

VII **Tabela 1**

Nr.	Emertimi i Artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar	Data e nënshkrimit të fillimit të kontratës së furnizimit	Data e përfundimit të afatit kontratës së furnizimit
1				
2				
3				
4				
5				
Etj				

Shënim:

Operatori ekonomik fitues duhet të sjellë kopjet e kontratave të deklaruara sipas tabelës nr 1, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga shpallja e fituesit përfundimtar.

III.9.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Agro Koni” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Deklaratë e operatorit ekonomik “Agro – Koni” SHPK, me nr.11/09 prot., datë 21.02.2022, me përmbajtje si vijon:

“Në, Kompania “Agro – Koni” SHPK me nipt J81409001P, në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë 21.02.2022, nga Autoriteti Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me objekt kontratë/marrëveshje kuadër “Blerje Artikuj Ushqimorë” ndarë në 7 (shtatë) lote/ Loti 7 “Blerje Fruta – perime” me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj; - REF-16658-12-29-2021, me fond limit të marrëveshjes kuadër 166,637,440 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katërqind e dyzet) lekë (pa TVSh). Referuar kërkesës në Shtojcën 1 dt. 17.01.2022, Seksioni 2

1.KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

2.Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.4 Kapaciteti teknik:

VIII 6. Në rast se operatori pjesëmarrës nuk është prodhues, por do të veproj me kontrata furnizimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen dhe operoret me te cilët janë lidhur këto kontrata duhet ta ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit ne fuqi.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, deklarojmë se Operatori Ekonomik “Agro – Koni” SHPK me Nipt J81409001P si pjesë e aktivitetit të saj disponon edhe Serë për prodhimin e Perimeve të freskëta, me sipërfaqe 16739 m2, si dhe licencën lëshuar nga QKB, Licencë II.1.C ,e nr LN-3906-10-2011. Për prodhimin e Fruta perimeve. Gjithashtu ne funksionojmë si pikë Grumbullimi dhe Eksporti për Fruta dhe Perime për Fermerët, Zonave (Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnje, Berat, Elbasan, Korçë, Sarandë, Shkodër etj.) Për sa më sipër po paraqesim disa kontrata furnizimi edhe nga fermerë dhe tregtarë, për furnizim me Fruta dhe Perime, sipas tabelës më poshtë:

Tabela 1

[...]

III.9.3. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konstatoj se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit në rast se nuk janë prodhues, por do të përmbushin kërkesat e AK me kontrata furnizimi për të gjithë artikujt objekt-prokurimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen sipas tabelës nr.1. Operoret palë të këtyre kontratave furnizimi duhet ta ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit ne fuqi. Operatori ekonomik fitues duhet të sjellë kopjet e kontratave të deklaruara sipas tabelës nr. 1, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga shpallja e fituesit përfundimtar. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për mospërmbushje të këtij kriteri nga operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK, nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga ky i fundit për përmbushjen e kriterit të mësipërm,

konstatohet se operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK ka paraqitur dokumentin ‘Deklaratë’, ku ky i fundit deklaron se si pjesë e aktivitetit të saj disponon edhe Serë për prodhimin e Perimeve të freskëta, me sipërfaqe 16739 m², si dhe funksionon si pikë Grumbullimi dhe Eksporti për Fruta dhe Perime për Fermerët, Zonave (Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnje, Berat, Elbasan, Korçë, Sarandë, Shkodër etj.), por deklaron gjithashtu se disponon disa kontrata furnizimi me fermerë dhe tregtarë, për furnizim me Fruta dhe Perime, duke plotësuar tabelën e dhënë nga autoriteti kontraktor me emërtimin e artikullit ; prodhuesin/distributorin e autorizuar ; datën e nënshkrimit të kontratës së furnizimit dhe datën e përfundimit të afatit të furnizimit, duke përmbushur kështu kërkesën e autoritetit kontraktor. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit se « *Ndër të tjera ky subjekt deklaron se është prodhues edhe i frutit të bananes dhe bizeles së ngrirë* », nga shqyrtimi i deklaratës së mësipërme, konstatohet se autoriteti kontraktor ka deklaruar kontrata furnizimi për këto produkte.

Pra sa më sipër, duke qenë se autoriteti kontraktor, në kriteret e kualifikimit ka kërkuar shprehimisht përmbushjen e këtij kriteri me anë të një deklaratë nga operatori ekonomik i cili pretendon të fitojë kontratën, konstatohet se operatori ekonomik “Agro – Koni” SHPK, me dokumentacionin e paraqitur e ka përmbushur këtë kriter. Akoma më tej në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se “*Operatori ekonomik fitues duhet të sjellë kopjet e kontratave të deklaruara sipas tabelës nr. 1, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga shpallja e fituesit përfundimtar*”, pra sa më sipër, ky kriter kualifikimi në këtë fazë konsiderohet i përmbushur nëpërmjet paraqitjes së deklaratës nga operatori ekonomik.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK nuk qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Agro Koni” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se “*Oferta e paraqitur nga Agro Koni ShPK duke qenë në kushtet e ofertës anomalisht të ulët nuk është bërë sipas kërkesave të Ligjit Nr.162/2020 Për Prokurimin Publik, Neni 93, Oferta anomalisht e ulët, duke mos dhënë shpjegime për anën ekonomike sipas kriterëve:*

- a) *anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) *zgjdhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;*
- c) *origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) *pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*
- d) *mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*”, vërej se,

III.10.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP-së me shkresën protokolluar me tonën me nr. 647/5 prot., datë 18.05.2022, si dhe nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se KVO gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në aplikim të formulës mbi ofertën anomalisht të ulët ka konstatuar, se oferta e

shoqërisë “Agro-Koni” SHPK është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët. Në këto kushte KVO me shkresën me nr. 430 prot., datë 11.03.2022 i është drejtuar operatorit ekonomik me kërkesë për sqarim/ argumentim oferte anomalisht të ulët sipas nenit 93 të LPP-së.

III.10.2. Në përgjigje të kërkesës së KVO, më datë 17.03.2022 operatori ekonomik “Agro-Koni” SHPK me qëllim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka paraqitur në mënyrë shkresore dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresë nr. 171 prot., datë 17.03.2022, me objekt: “Sqarim mbi ofertën anomalisht më të ulët”, protokolluar në autoritetin kontraktor me nr. 461 prot., datë 17.03.2022. Në këtë shkresë, ndër të tjera, thuhet se: “[...]Duke qenë se operatori ekonomik Agro Koni SHPK është një kompani e regjistruar në QKB në datë 16.01.1998, me një eksperiencë dhe përvojë shumëvjeçare në treg, e cila numëron një sërë projektesh dhe kontrata të realizuara me sukses për furnizim mallra fruta perime. Kompania jonë gjithashtu funksionon dhe si pikë grumbullimi për fruta dhe perime në të gjithë territorin e Shqipërisë, kryesisht në Zonën e Lushnjë, Berat, Fier, Elbasan, Sarandë, Korçë, Shkodër, Kukës dhe jo vetëm. Kompania jonë ka lidhur kontrata bashkëpunimi për grumbullimin e perimeve dhe të frutave me çmime fikse dhe variable sipas cilësisë së prodhimit që prodhohet nga fermerë në zona të ndryshme të Republikës së Shqipërisë. Këto kontrata janë pasqyruar dhe në dorëzimin e dokumentacionit të plotë të dorëzimit të ofertës. Gjithashtu duam të sjellim në vëmendje se kompania Agro Koni disponon në pronësi të saj sera prodhimi me dokumentacion të rregullt dhe me kushtet sipas ligjit për prodhimin e frutave dhe perimeve, duke na krijuar mundësinë që një pjesë të mallrave fruta dhe perime ti prodhojmë vetë, prandaj edhe kemi një kosto shitje më të ulët se kompanitë e tjera. Në dosjen e dokumentacionit të dorëzuar nga kompania jonë kemi përfshirë të gjithë dokumentacionin provues për pronësinë e serave. Më poshtë po ju paraqesim një analizë të kostove të çmimeve lek/kg

Nr.	Emërimi i artikujve	Njësia matëse	Kosto e prodhimit lek/kg	Cmimi i blerjes tek fermeret lek/kg	Shpenzime operacionale lek/kg	Fitimi lek/kg	Cmimi për një lek/kg
-----	---------------------	---------------	--------------------------	-------------------------------------	-------------------------------	---------------	----------------------

Tek emërtimi i artikujve jepen të gjitha artikujt objekt-kontrate.

Gjithashtu duam të sjellim në vëmendje se kompania Agro Koni disponon në pronësinë e saj sera prodhimi me dokumentacion të rregullt dhe me kushtet sipas ligjit për prodhimin e frutave dhe perimeve, duke na krijuar mundësinë që një pjesë e mallrave të fruta dhe perime i prodhojmë vetë, prandaj edhe kemi një kosto shitje më të ulët se kompanitë e tjera. Në dosjen e dokumentacionit të dorëzuar nga kompania jonë kemi përfshirë të gjithë dokumentacionin provues për pronësinë e serave. Kompania Agro Koni SHPK, në zbatim të dispozitave ligjore që parashikon legjislacioni shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve të punës, duke respektuar dhe shlyer çdo detyrim ligjor për pagesat e kontributeve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ka stafin e mjaftueshëm dhe të nevojshëm të angazhuar si fuqi punëtore e jonë, e cila është vënë në dispozicion të prodhimit të perimeve dhe frutave në zonën ku ne kemi Fermën, e cila relativisht është e përfshirë dhe llogaritur në koston tonë të prodhimit dhe të grumbullimit nga fermerët. Në dosjen e dokumentacionit që kemi dorëzuar në ofertë kemi deklaruar çdo dokument, si Listëpagesat, kontrata e punës, vërtetimin për shlyerjen e kontributeve, vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve vendore, që vërteton se kemi

shlyer të gjitha detyrimet për taksat, tatimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për respektimin e kërkesave dhe rregullave për pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

Të gjitha përparësitë e faktet e mësipërme mundësojnë që kompania jonë të operojë me çmime kompetitive në tregun shqiptar, si edhe përvoja jonë në angazhimin e projekteve të realizuara cilësisht dhe në kohë pa asnjë reklamim nga klientët e shumtë, përbëjnë bazat të cilat garantojnë dhe sigurojnë suksesin edhe në rastin e kontratës me objekt Lotin 7 “Blerje fruta – perime”. Duke marrë parasysh faktorët e mësipërm dhe planin e detajuar të realizimit të Kontratës, baza e llogaritjes së vlerës së projektit janë kostot e perimeve dhe frutave si më poshtë të pasqyruara në tabela: *Bashkëlidhur kësaj shkrese*. Konstatohet se operatori ka dorëzuar edhe analizë kosto për proceset e punës: A.Me mjete mekanike (transport, plugim, frezim, spërkatjet etj) , B.Punime me krahe (pastrim parcele/dezinfektim, plehrim organik, mbjellje, trajtime kimike, shërbime gjatë vegjetacionit, vjelje, ngarkim/shkarkim, seleksionim/ambalazhim prodhimi), C.Materiale (fara/fidane, pleh organik, pleh kimik, pesticide, ujë, energji elektrike, karburant, plasmas për mbulim) etj [...].

III.10.3. Në nenin 93 pika 1 dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.10.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.10.5. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik “Agro Koni” SHPK, si edhe nga përlogaritjet e kryera, konstatohet, se oferta ekonomike në vlerën prej 100.032.065 lekë pa TVSh, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. Theksoj faktin, që shpjegimet e operatorëve ekonomikë për ofertën anomalisht të ulët, duhet të lidhen me kushtet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nga ku katër kushtet e para janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe në këtë vështrim. Mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që operatori ekonomik të dështojë në argumentimin mbi paraqitjen e ofertës anomalisht të ulët, ndërsa kushti i pestë lidhet me *mundësinë* e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore, çfarë do të thotë, që jo çdo ofertues mund ta sigurojë këtë ndihmë dhe si rrjedhojë në ato raste kur ajo nuk është e mundur të sigurohet, mosplotësimi i këtij kushti nuk përbën shkak për dështimin e operatorit në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, nëse operatori ekonomik ofertues ka arritur të argumentojë/provojë me dokumente shkresore plotësimin e katër kushteve të para kumulative të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” “ç” të pikës 2 të nenit 93 të *lex specialis*.

Në interpretim literal të nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si anomalisht e ulët. Gjithashtu, argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative, për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik do të përmbushë me sukses kontratën. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve, ose për kryerjen e punës. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi. Ata duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, si edhe së fundmi të argumentojnë apo provojnë *mundësinë* e tyre për të përfituar ndihmë shtetërore. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente, duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. **Gjykoj, se nga interpretimi teleologjik i normës**

së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. KPP gjykon, se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime, ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kostot që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga moskryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të moszbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, theksoj se referuar nenit 2 gërma “b” “Qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se; *“Qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”*. Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës, që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe *mundësinë* për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.10.6. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Agro Koni” SHPK, në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët të paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton, se ky i fundit është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht, vlerësoj, se operatori ekonomik “Agro Koni” SHPK, ka paraqitur si dokumentacion mbështetës ose provues: argumentimin e ofertës në mënyrë narrative përmes shkresës nr. 171 datë 17.03.2022 me lëndë “Sqarim për ofertën anomalisht të ulët”, ku ka shpjeguar të gjitha elementet e ofertës së paraqitur prej tij dhe duke e justifikuar çmimin e ofertuar bazuar në disa komponentë. Konkretisht ankimesi ka deklaruar se: *“...Duke qenë se operatori ekonomik Agro Koni SHPK është një kompani e regjistruar në QKB në datë 16.01.1998, me një eksperiencë dhe përvojë shumëvjeçare në treg, e cila numëron një sërë projektesh dhe kontrata të realizuara me sukses për furnizim mallra fruta perime. Kompania jonë gjithashtu funksionon dhe si pikë grumbullimi për fruta dhe perime në të gjithë territorin e Shqipërisë, kryesisht në Zonën e Lushnjë, Berat, Fier, Elbasan, Sarandë, Korçë, Shkodër, Kukës dhe jo vetëm. Kompania jonë ka lidhur kontrata bashkëpunimi për grumbullimin e perimeve dhe të frutave me çmime fikse dhe variable sipas cilësisë së prodhimit që prodhohet nga fermerë në zona të ndryshme të Republikës së Shqipërisë. Këto kontrata janë pasqyruar dhe në dorëzimin e dokumentacionit të plotë të dorëzimit të ofertës. Gjithashtu duam të sjellim në vëmendje se kompania Agro Koni disponon në pronësi të saj sera prodhimi me dokumentacion të rregullt dhe me kushtet sipas ligjit për prodhimin e frutave dhe perimeve, duke na krijuar mundësinë që një pjesë të mallrave fruta dhe perime ti prodhojmë vetë, prandaj edhe kemi një kosto shitje më të ulët se kompanitë e tjera. Në dosjen e dokumentacionit të dorëzuar nga kompania jonë kemi*

përfshirë të gjithë dokumentacionin provues për pronësinë e serave. Më poshtë po ju paraqesim një analizë të kostove të çmimeve lek/kg

Nr Emërimi i artikujve Njësia matëse Kosto e prodhimit lek/kg Cmimi i blerjes tek fermeret lek/kg Shpenzime operationale lek/kg Fitimi lek/kg Cmimi për një lek/kg

Tek emërtimi i artikujve jepen të gjitha artikujt objekt kontrate.

Gjithashtu duam të sjellim në vëmendje se kompania Agro Koni disponon në pronësinë e saj sera prodhimi me dokumentacion të rregullt dhe me kushtet sipas ligjit për prodhimin e frutave dhe perimeve, duke na krijuar mundësinë që një pjesë e mallrave të fruta dhe perime i prodhojmë vetë, prandaj edhe kemi një kosto shitje më të ulët se kompanitë e tjera. Në dosjen e dokumentacionit të dorëzuar nga kompania jonë kemi përfshirë të gjithë dokumentacionin provues për pronësinë e serave. Kompania Agro Koni SHPK, në zbatim të dispozitave ligjore që parashikon legjislacioni shqiptar për rregullimin e marrëdhënieve të punës, duke respektuar dhe shlyer çdo detyrim ligjor për pagesat e kontributeve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ka stafin e mjaftueshëm dhe të nevojshëm të angazhuar si fuqi punëtore e jonë, e cila është vënë në dispozicion të prodhimit të perimeve dhe frutave në zonën ku ne kemi Fermën, e cila relativisht është e përfshirë dhe llogaritur në koston tonë të prodhimit dhe të grumbullimit nga fermerët. Në dosjen e dokumentacionit që kemi dorëzuar në ofertë kemi deklaruar çdo dokument, si Listëpagesat, kontrata e punës, vërtetimin për shlyerjen e kontributeve, vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve vendore, që vërteton se kemi shlyer të gjitha detyrimet për taksat, tatimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për respektimin e kërkesave dhe rregullave për pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

Të gjitha përparësitë e faktet e mësipërme mundësojnë që kompania jonë të operojë me çmime kompetitive në tregun shqiptar, si edhe përvoja jonë në angazhimin e projekteve të realizuara cilësisht dhe në kohë pa asnjë reklamim nga klientët e shumtë, përbëjnë bazat të cilat garantojnë dhe sigurojnë suksesin edhe në rastin e kontratës me objekt Lotin 7 “Blerje fruta – perime”. “... Përveç kësaj, ankimesi në mbështetje të deklarimeve më sipër, ka paraqitur Analizë kosto prodhimi, për artikujt objekt-prokurimi, si më poshtë:

	Produkti	sipërfaqja	dn	10	Rendimenti
Nr.	Emertimi i zerave te kostos	njësia	sasia	Cmimi/njëis	Vlera ALL
A	Me mjete mekanike				
1	Transporte				
2	Plugim				
3	Frezim				
	Shuma me mekanike				
B	Punime me krahë				
1	Pastrim parcele/dezinfektim				
3	Plehërim organik				
4	Plehërim kimik bazë				

5	Mbjellje/fidana/fare				
6	Trajtime kimike				
7	Sherbime gjatë vegjetacionit				
8	Vjelje prodhimi				
9	Ngarkim/shkarkime				
10	Seleksionim/ambalazhim prodhimi				
	Shuma me krahe				
C	Materiale				
1	Fara/fidana				
2	Pleh organik				
3	Pleh kimik npk				
4	Pesticide				
5	Ujë				
6	Energji elektrike				
7	Karburante				
8	Ferromone				
9	Polenizues/Bumble bee				
10	Plasmas për mbulim				
	Shuma materiale				
	Shuma gjithësej (A+B+C)				
	Te tjera shpenzime 5%				
	Te ardhura nga shitjet sezoni I				
	Totali i shpenzimeve Sezoni I				
	Fitimi				
	Kostoja e prodhimit				

III.10.7. Gjykoj, se ankimuesi në rastin konkret ka arritur nëpërmjet dokumentacionit provues sa më sipër, të argumentojë të gjitha elementet e ofertës së tij. Përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon, të tilla si eksperiencia e gjatë në treg, realizmi i një sërë kontratash me subjekte të ndryshme, faktin se ky subjekt shërben si një pikë grumbullimi për fruta dhe perime në të gjithë Shqipërinë, si dhe disponon në pronësi sera prodhimi. Subjekti “Agro Koni” SHPK ka paraqitur edhe analizën e detajuar të kostos në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP ku

flitet për anën ekonomike të **metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjithë elementët.**

Në rastin konkret, gjykoj, se nga ana e operatorit ekonomik “Agro Koni” SHPK janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga ofertuesi, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Gjithashtu, referuar edhe faturave të dorëzuar në SPE si dëshmi e eksperiencës së ngjashme, konstatoj se për zërat objekt furnizimi operatori ekonomik ka dëshmuar se ka furnizuar subjekte private në vitet e kaluara me çmime edhe më të ulta se çmimet e deklaruara në ofertë, pra ka dëshmuar përmbushjen me sukses pa risk dështimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” SHPK, nuk qëndron.

Kryetar
Jonaid Myzyri